

DEKLARATË E PËRBASHKËT
e
Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë
dhe
Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës së Shqipërisë

Duke konsideruar se:

- një sistem i jashtëm auditimi efektiv dhe eficient përbën një nga shtyllat moderne të një shteti demokratik;
- të dy institucionet janë të lidhura nëpërmjet marrëdhënieve miqësore profesionale, të konsoliduara nga një histori e seminareve, workshop-eve dhe trajnimeve të përbashkëta, të cilat synojnë rritjen e njohurive të audituesve dhe zhvillimin e institucioneve;
- të dy institucionet janë të interesuara në një bashkëpunim të drejtpërdrejtë për forcimin e kapaciteteve audituese të vendeve të tyre;
- marrëveshja e bashkëpunimit e nënshkruar më 22 maj 2012 midis Kontrollit të Lartë të Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës Supreme të Auditimit të Republikës së Polonisë, në të cilën konfirmohet interesi dhe gatishmëria e institucioneve për bashkëpunim;
- kontrata e projektit të binjakëzimit nr. AL 13 IB FI 01, datë 25 shkurt 2016 ofron mundësi për bashkëpunim dhe shkëmbim të njohurive e eksperiencave duke implementuar projektin i cili i kushtohet forcimit të kapaciteteve të auditimit të jashtëm të Kontrollit të Lartë të Shtetit;

Kontrolli i Lartë i Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe Zyra Supreme e Auditimit të Republikës së Polonisë konfirmojnë se:

- janë të angazhuara për të arritur objektivat e përmendura më sipër të projektit të binjakëzimit, të cilat kontribuojnë në përdorimin me efektivitet, eficiencë, transparencë dhe përgjegjshmëri të fondeve publike;
- objektivat e projektit të binjakëzimit do të implementohen në përputhje me praktikat në të mira të BE dhe standardet e aplikuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI);
- do të punojmë ngushtësisht së bashku për arritjen e rezultateve të pritshme të aktiviteteve të projektit të listuara në Kontratën e Projektit të Binjakëzimit të përmendur më sipër;
- janë të gatshme të angazhojnë stafin e tyre për implementimin e projektit të binjakëzimit;
- janë të gatshme të japin çdo mbështetje që kërkohet për implementimin e aktiviteteve të projektit, të përshkruara në Kontratën e Projektit të Binjakëzimit;
- janë të plotësisht të vetëdijshme për përgjegjësitë që rezultojnë nga Kontrata e Projektit të Binjakëzimit.

Bujar LESKAJ
Kryetar
Kontrolli i Lartë i Shtetit
Republika e Shqipërisë

Krzysztof KWIATOWSKI
President
Zyra Supreme e Auditimit
Republika e Polonisë